REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

Nr. 793 Prot. Fier,më 06.05.2022

RISHPALLJE 1

E VENDIT TË LIRË PËR DREJTOR TË INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT

Në mbështetje të ligjit nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar, vendimit nr.99, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave , ''Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar'', Udhëzimin nr.2, datë ''Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar'', i ndryshuar, DRAP Fier shpall vendet e lira të punës si drejtues institucionesh arsimore në ZVAP-ve në juridiksionin e saj sipas listës bashkëlidhur:

1.Aplikantët e intereuar për pozicionet e drejtuesve të institucioneve arsimore duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtëme:

a) të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar" me vlerësimin jo më pak se ''mirë'', në kualifikimin e fundit.

c) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;

d) të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar ose të jetë pranuar për ta kryer atë.

2. Aplikantët për pozicionin e drejtorit në IPAP duhet të dorëzojnë.

a) jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

b) kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës;

c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);

d) tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

e) certifikatën e drejtuesit të IPAP ose vërtetim nga shkolla e drejtorëve që është pranuar për të kryer trainimin e detyrueshëm.

f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

h) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2, dorëzohet nëpërmjet **shërbimit postar** në ZVAP-në përkatëse ku ndodhet shkolla në të cilën aplikanti këkon të konkurojë.

Datat fazave brenda procedurës.

1. **Dërgimi me postë brenda datës 16.05.2022**
2. Mbledhja e komisionit brenda datës 19..05.2022
3. Hartimi i listës për vlerësim pas verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen jo më vonë se data **26.05.2022.** Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.
4. Brenda datës **30.05.2022,** Komisioni shpall në këndin e njoftimeve të IPAP tabelën e pikëve totale të secilit kandidat, sipas shtojcës nr. 6 , bashkelidhur këtij udhezimi.
5. Afatet e ankimimit nga kandidatet, për komisionin janë deri më datë **01.06.2022. Brenda datës 02.06.2022,** Komisioni duhet tu kthejë përgjigje ankimuesve.
6. Kryetari i Komisionit dorëzon Drejtorit të ZVAP dosjet për dy kandidatët me më shumë pikë.
7. Drejtori i ZVAP, pas shqyrtimit të dokumentacionit në ZVAP-in përkatës, përcjell dokumentacionin për dy kandidatët me më shumë pikë në DRAP, brenda datës **06.06.2022**.
8. Drejtori i DRAP, brenda datës **13.06.2022**, interviston dy kandidatët dhe brenda datës **16.06.2022,** shpall vendimin për kandidatin fitues, për pozicionin e drejtorit të IPAP.
9. Kandidati jofitues ka të drejtën e ankimit në MAS brenda 3(tre) ditë punë nga shpallja e kandidatit fitues.

10. MAS brenda 10 ditëve pune kthen përgjigje ankesës.

Në përfundim të të gjithë fazave të mësipërme, Drejtor i DRAP, bën emërimin e drejtorit të IPAP.

Fusha e njohurive dhe aftësitë në drejtimin e institucionit mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar:

- Ligji nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar.
- Vendimit nr.99, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave , ''Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar''.
- Ligjit 119/2014 ''Për të drejtën e informimit'',
- Ligji nr.9887, datë 10.03.2008, ''Për mbrojtjen e të dhënave personale'',
- Ligjit 9667, datë 07.04.2005 ''Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e ushtrimin e funksioneve publike''
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Udhëzimin nr.2, datë 28.01.2020 ''Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar'', i ndryshuar.
- Udhëzimin ''Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të nendrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar'',
- Udhëzimin nr.12, datë 10.06.2021, ''Për procedurat e pranimit dhe të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore dhe për administrimin e portalit ''Mësues për Shqipërinë'',
- Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të arsimit parauniversitar.

Bashkëlidhur lista me vendet vakante për cdo ZVAP

DREJTOR

FLUTURA MECAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar FIER DRITARIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

GRAFIKU I KONKURSEVE PER DREJTOR TE IPAP

RISHPALLJA 1

6.05.2022 – 16.06.2022

Nr	Shkolla	ZVA
1	LLAZAR DASH	FIER
2	XHEVIT FETAHU	FIER
3	JANI BAKALLI	FIER
4	DINO ISMAILI	FIER
5	GJUZAJ	LUSHNJE
6	PETRO POGA	GJIROKASTER
7	NAIM FRASHERI	GJIROKASTER
8	SHKOLLA SPECIALE PLM	VLORE
9	LEF SALLATA	VLORE
10	HALIM XHELO	VLORE
11	ISMAIL QEMALI	VLORE